



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Agjencia e Statistikave të Kosovës shpallë: **KONKURS TE BRENDESEM** për këto vende te punës:

1. Departamenti i Statistikave sociale

Titulli: Një (1) Drejtor te departamentit te Statistikave sociale

Numri i referencës : ASK-DSS-001

Koeficienti : 10

Detyrat kryesore:

1. Bën menaxhimin dhe organizimin e punëve të departamentit të statistikave sociale, demografike dhe hulumtimeve kërkimore sociale, përgjegjës për planifikimin, realizimin, mbikëqyrjen e politikave të departamentit (krahasimi i aktiviteteve të realizuara me ato të planifikuara, funksionalizimi i Departamentit sipas riorganizimit, realizimi i planit vjetor)
2. Udhëheqë punët në përgatitjet e programit dhe planit operativ të hulumtimeve statistikore, bënë planin njëvjeçar të punës dhe përgatit programin pesëvjeçar të punës.
3. Mbikëqyrë të gjitha fazat statistikore (përgatitjen e instrumenteve statistikore, grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave statistikore).
4. Bënë udhëheqjen metodologjike të përditshme të Departamentit të Statistikave Sociale
5. Vë në shfrytëzim klasifikimet, standardet dhe metodologjitë të Eurostat-it për zhvillimin e statistikave sociale, demografike dhe hulumtimeve kërkimore sociale, si dhe jep propozime për avancimin dhe azhurnimin e statistikave sociale dhe demografike.
6. Siguron krahasueshmërinë e të dhënave të statistikave sociale, demografike dhe kërkimeve sociale me ato ndërkombëtare.

7. Bën vlerësimin kualitativ të të dhënave nga publikimet dhe kujdeset për aftësimin profesional të stafit si dhe bën mbikëqyrjen e afatit të realizimit të aktiviteteve dhe publikimeve sipas planit dinamik.
8. Siguron bashkëpunimin e ngushtë me ministrinë përkatëse, me institutet shkencore, Universitetin e Prishtinës lidhur me avancimin e statistikave sociale,
9. Përgatit raportet e punës javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore si dhe kryen detyra të tjera shtesë sipas kërkesës së KE.

-Kualifikimi : Diplomë universitare nga shkencat sociale , fakulteti ekonomik apo të ngjashme.

-Përvoja e punës: kandidati duhet të ketë 7 vite përvojë pune dhe atë 4 vite përvojë pune në vende udhëheqëse.

-Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohuri mbi indikatorët social dhe demografik
- Shkathtësi të dëshmuara të zhvillimit të mbajtjes së trajnimit, instruktimit dhe monitorimit
- Të jete energjik ,shkathtësi të mira ndër njerëzore dhe të jete i gatshëm të punoj me orar fleksibilitet të punës dhe trysni kohe.
- Shkathtësi në udhëheqje dhe menaxhim , duhet të ketë aftësi për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave që kanë të bëjnë me punën.
- Njohuri të punës me kompjuter (*Word, Excel, Access, SPSS, etj*)
- Njohuri nga gjuha angleze

2. Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit

Titulli: Një (1) Udhëheqës i zyrës rajonale të statistikës në Mitrovicë

Numri i referencës : ASK-DRA-002

Koeficienti : 8

Detyrat kryesore:

1. Është përgjegjës për planifikimin,organizimin,realizimin dhe mbikëqyrjen e punës në Zyrën rajonale të statistikës në Mitrovicë.
2. Koordinon punët me Departamentet e ASK-ës, në realizimin e programit të kërkimeve statistikore, të cilat i ka miratuar ASK-ja, në terrenin e komunave që mbulon Zyra rajonale në Mitrovicë.
3. Kujdeset për trajnimin e personelit, përvetësimin e metodologjive dhe të pyetësorëve nga ana e personelit.
4. Organizon ndarjen e punëve për personelin e Zyrës , kujdeset për dinamikën e punëve , bënë sistemimin , klasifikimin dhe kontrollimin logjik të të dhënave të grumbulluara.
5. Është përgjegjës për menaxhimin profesional të personelit si dhe ndertimit të raporteve efektive me punëtorët e Zyrës rajonale në pajtim me ligjin për Sherbim Civil,
6. Është përgjegjës për menaxhimin e mirë të pasurisë së Zyrës rajonale.

7. Zhvillon raporte të mira bashkëpunimi me responentët dhe shtëzuesit e të dhënave statistikore në Rajonin që e mbulon Zyra Rajonale .

8. Propozon dhe delegon në pajtueshmëri me Drejtorin e departamentit të Regjistrimeve dhe Anketimeve , të punësuarit në Zyrën rajonale në aftësimin profesional dhe trajnime tjera te nevojshme.

9. Merr pjesë në aktivitetet e tjera sipas kërkesës së Drejtorit të departamentit , bazuar në Ligjin e ri për Statistikat Zyrtare të Republikës të Kosovës si dhe raporton te Drejtori i departamentit të Regjistrimeve dhe Anketimeve për dinamikën e aktiviteteve sipas agjendës që ka parashtruar ASK-ja

-Kualifikimi : Diploma universitare ne fushën juridike ose ekonomike, apo te ngjashme

-Përvoja e punës: Së paku 5 vite përvojë pune.

-Kompetenca dhe aftësitë:

-Njohuri dhe aftësi ne përdorimin e kompjuterit (Wordit, Excelit dhe Outlook) ,

- Kandidati duhet të ketë aftësi te njohjes se gjuhës shqipe dhe atë serbo-kroate,

-Azhuur dhe i gatshëm ne kryerjen e detyrave te punës,

-Kandidati duhet të ketë aftësi të komunikimi për pune ekipore,

- Te këtë aftësi te ruajtjes se konfidencialitetit të të dhënave që kanë të bëjnë me punën-e .

Procedura e konkurimit:

Procedura e konkurimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues në ASK, të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim.

Kërkesat për punësim mirren në Zyrën e Arhivës të ASK-së.

Së bashku me formularin për punësim duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmit për përvojën e punës , vlersimin e fundit të punës si dhe dokumentacione të tjera që lidhen me vendin e punës.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Aplikacionet merrën dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

ASK, ofron mundësi të barabarta të rekrutimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda ASK-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil.

Afati i konkurimit është prej dt.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në Web-faqen e ASK dhe në Tabelën e Shpalljeve të ASK.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutem të informoheni me Zyrën e personelit në ASK.

Kryeshefi Ekzekutiv
Isa Krasniqi
